



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Primiheho/Prodato Received/Delivery | 12.04.2023 | 3 | viti god year |
| Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKIMBIXK | 3484 | 2023 | 1/5 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr 781/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar, Malsore Gashi dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2820/21 i datës 27.02.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.781/2021 e datës 03.09.2021 të parashtruar nga ankuesja [redacted] i me adresë banimi [redacted] Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 12.04.2023, mori këtë;

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr. 781/2021 e datës 03.09.2021, e parashtruar nga ankuesja.
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër Nr.241/VIII/2021 i datës 06.08.2021 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.

A r s y e t i m

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë me datë 06.08.2021, me Nr.241/VIII/2021 ka nxjerr vendim lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësen civile [redacted], duke i njohur të drejtën e një pagë përcjellëse në rastin e pensionimit si dhe në pikën tre (3) e lartpërmendura, gjithashtu gëzon të drejtën e kompensimit të njëzet e tetë (28) ditëve të pushimit vjetor të pashfrytëzuara, në vlerë prej 871.60 Euro.

Ankuesja , e pakënaqur me vendimin me numër Nr.241/VIII/2021 të datës 06.08.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datë 03.09.2021 me numër protokoll 4491/2021 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës , me pretendimet ankimore se organi i punësimit me rastin e pensionimit të saj duhet ti bëjë pagesën e tri (3) pagave jubilarë, tri (3) pagave pas arritjes së moshës së pensionimit dhe shujtës ditore në vlerë dy (2) Euro në ditë, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ndërsa ankueses i është bërë pagesa e vetëm një page si dhe kompensimi i njëzet e tetë (28) ditëve të pushimit vjetor të pashfrytëzuara.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.09.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa Këshilli më datë 21.03.2023, me numër protokoll 2837/2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Shëndetësisë, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.10.2021 përmes Njoftimit me numër protokoll 5083/2021 ka njoftuar ankuesen se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.nr.781/2021 të datës 03.09.2021, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, dhe ka udhëzuar të njëjtën mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 27.02.2023 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.2820/21, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 14.03.2023 sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 18.10.2021, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda tridhjetë 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 03.09.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokoll 4491/2021 të datës 03.09.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.2820/21 i datës 27.02.2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i njëjti në Këshill është pranuar me datë 14.03.2023 me numër protokoll 2616/2023; Vendimi me numër Nr.241/VIII/2021, i datës 06.08.2021 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë; Vendim me numër Nr.DBNJ-70/15 i datës 05.08.2015; Lista e pagave e datës 01.07.2021 deri 31.07.2021; Kartela e nëpunësit M.K.; Njoftim me numër protokoll 5083/2021 i datës 18.10.2021; Fletëkthesë e datës 02.11.2021; Fletëkthesë e datës 09.09.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokoll 4508/2021 e datës 06.09.2021; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 2837/2023 e datës 21.03.2023; Lista e pagave e datës 01.08.2021 deri 31.08.2021; Lista e pagave e datës 01.08.2021 deri 31.08.2021; Lista e pagave e datës 01.08.2021 deri 31.08.2021; E-mail nga H.S. për C.Z. i datës 06.04.2023; E-mail nga C.Z. për H.S. i datës

06.04.2023; Lista e pagave e datës 01.08.2021 deri 31.08.2021; Lista e pagave e datës 01.08.2021 deri 31.08.2021; Lista e pagave e datës 01.05.2014 deri 31.05.2014; E-mail nga C.Z. për H.S. i datës 16.03.2023;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës parasheh që punëtorëve ju takon pagesa e tri (3) pagave jubilarë, tri (3) pagave pas arritjes së moshës së pensionimit dhe shujtës ditore në vlerë dy (2) Euro në ditë, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"*, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: *"Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës"*, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: *"Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit"*, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes.

Meqenëse konstatohet se nga data 15.09.2017 Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshëm, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse më nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka konstatuar se marrëdhënia e punës së ankueses me rastin e pensionimit i ka përfunduar sipas Vendimit me numër Nr.241/VIII/2021 të datës 06.08.2021, atëherë kompensimi i tri pagave me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë sipas Marrëveshjes Kolektive të Kosovës nuk mund të bëhet.

Ministria e Shëndetësisë, me rastin e kompensimit të një page mujore të njëhershme në vlerën e pagesës së fundit, sipas vendimit me numër Nr.241/VIII/2021 i datës 06.08.2021, të nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, ka vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: *"Paragrafi 1. Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit". Paragrafi 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page*

"mujore të njehershme në vlerën e pagesë së fundit", rrjedhimisht Ministria e Shëndetësisë ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që ti bëhet pagesa e shpërblimit jubilar, ka konstatuar që ankueses në muajin Maj 2014 është kompensuar në vlerën 82.70 Euro në emër të shpërblimit jubilar, në këtë rast Ministria e Shëndetësisë ka kryer obligimin ligjor ndaj ankueses lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar, duke vepruar në pajtim me dispozitat e Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil respektivisht me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 ku përcaktohet se: *"Nëpunësit civil, kanë të drejtat në vijim: shpërblimi i përvojtorit (jubile)"* si dhe nenin 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil ku përcaktohet se: *"Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil, nëpunësve civil, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune"*, ndërsa ky kompensim nuk mund të bëhet sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pa bazuara.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses për kompensimin e pagesës për ushqim ditor në vlerë prej dy (2) euro në ditë, për ditët e praninë në punë sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqenëse nga data 15.09.2017 Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshme, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse më nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente, atëherë kompensimi i ushqimit për ditët e pranisë në punë nuk mund të realizohet sipas kësaj marrëveshje, andaj këto pretendimet të ankueses janë në kundërshtim me nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, dhe si të tilla janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Vendimi me Nr.241/VIII/2021 i datës 06.08.2021 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.781/2021

Çlirim ZEKA

Çlirim
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së